# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-442631**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ancelotti konfirmon fundin e një epoke, Neymar largohet nga Brazili |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391500.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 09:55:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 09:53:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 09:52:00 UTC → 14 shtator 2026, 09:54:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `56ffc064c010db3fd9873395d37c3056a1991d16350c0dd3b20141421914e174` |
| TEKSTI | `fc36bc3b186864ef32ff3355a64126e7aa03f5525ef2f9239c3223751433705e` |
| PAMJA | `e150e3c49e0a63acad28972afe3bd32071eb9cae38cb7ff92496664752716900` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4027e4d70e3e93d7be7285faf84254daf3987f9a0fdc420460c59ed69b7bdb9b` |
| E MËPARSHMJA | `b61339c19c565a4bce68e9c2e7ab0295957e7d7460f21ff3f48ab9d5099e817d` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4027e4d70e3e93d7be7285faf84254daf3987f9a0fdc420460c59ed69b7bdb9b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ancelotti konfirmon fundin e një epoke, Neymar largohet nga Brazili

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 14.09.2026, 11:53

Share Share




Neymar duket se është pranë fundit të një prej kapitujve më të rëndësishëm të karrierës së tij. Pas një rruge të gjatë me fanellën e Brazilit, ylli brazilian nuk pritet të rikthehet më te kombëtarja, me Carlo Ancelottin që konfirmoi se vetë lojtari ka shprehur dëshirën për të mos u kthyer.

Karriera e Neymarit ka kaluar nëpër disa prej skenave më të mëdha të futbollit botëror. Ai shpërtheu me Santosin, përpara se të transferohej te Barcelona, ku formoi një nga treshët sulmues më të frikshëm të historisë së futbollit së bashku me Lionel Messin dhe Luis Suárezin.

Më pas erdhi transferimi rekord te Paris Saint-Germain, ku Neymar u bë qendra e një projekti ambicioz dhe vazhdoi të shfaqte klasin e tij, përpara se të kalonte te Al-Hilal në Arabinë Saudite. Pas eksperiencës në Lindjen e Mesme, ai u rikthye te Santos, aty ku gjithçka kishte nisur.

Me Brazilin, Neymar u shndërrua në një prej figurave më të mëdha të historisë së përfaqësueses. Gjatë viteve, ai mbajti mbi supe pritshmëritë e miliona tifozëve brazilianë dhe u kthye në golashënuesin më të mirë të historisë së kombëtares.

Por tashmë duket se koha për t'i dhënë fund këtij kapitulli ka ardhur.

Pas Messit, një tjetër prej yjeve më të mëdhenj të brezit të tij po largohet nga skena e kombëtareve. Neymar dhe Brazili duket se i kanë thënë lamtumirë njëri-tjetrit.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike
ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.